

VENDIM
Nr.627, datë 24.12.1999

PËR NJË SHITESË FONDI PËR APARATIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1.Aparatit të Këshillit të Ministrave, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohet një fond prej 4 300 000 (katër milionë e treqind mijë) lekësh, për pagimin e detyrimeve kundrejt shoqërisë “Albanian Airlindes”.

Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave

2.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Aparati i Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta